

**VENDIM**  
**Nr.66, datë 13.9.2010**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT  
PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR  
KONSUMATORËT TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**